

Fjala e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Z. Besnik DERVISHI

Dëshiroj t'ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë konferencë që i shërben punës për garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, për të kuptuar që çdokush duhet vlerësuar dhe konsideruar pa ju cënuar privatësia, pa ju keqpërdorur informacioni, por duke u dhënë ai në interes të rëndësishëm të publikut, me qëllimin e mirë për të bërë transparencë.

Duhet të vlerësoj Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (SOROS), iniciator i projektit dhe sot bashkë organizator i kësaj konferencë, Kuvendin, Këshillin e Ministrave, të gjithë kontribuesit në çdo tryezë diskutimi e debati, që solli miratimin e këtij ligji të ri për të drejtën e informimit e nga sot implementimin e tij.

Zyra e Komisionerit, përbëhet nga dy shtylla kryesore nga e drejta për informim dhe nga mbrojtja e të dhënave personale. Në rastin tonë, janë reflektuar praktikat dhe eksperiencat më të mira ndërkombëtare, ku e drejta për informim trajtohet bashkërisht me mbrojtjen e të dhënave personale, dy fusha që duhet të vendosin një balancë ndërmjet tyre, që privatësia e individit të mbrohet edhe kur jepet informacion për dokumentacionin zyrtar.

Për më tepër, trajtimi i këtyre dy të drejtave themelore të sanksionuara në Kushtetutë nga i njëjti autoritet, bën që të kenë një progres dhe ecuri të harmonizuar. Monitorimi dhe garantimi i këtyre të drejtave, i këtyre dy shtyllave të rëndësishme nga zyra jonë, nga njëra anë kërkon angazhim maksimal, por nga ana tjetër kërkon bashkëpunim me të gjithë ju, përfaqësues të autoriteteve publike, aktorë të shoqërisë civile, publikun.

Këto dy të drejta, zhvillohen me shpejtësi dhe intensitet në jetën tonë të përditshme dhe po bëhen gjithnjë e më shumë të rëndësishme. Për këdo ato duhet të jenë pjesë e njohurive, të kuptohen nën të bërin balancë, të përmbushen nga autoritetet me kompetencë dhe sa herë është e mundur të mbështesin njëra – tjetrën.

Duhet t'i njohim sfidat që mbart kjo botë e re të dhënash, kundrejt një mbrojtjeje të efektshme të të dhënave personale, dhe kërkesave të shumta për dhënie informacioni.

Institucionet publike përballen çdo ditë me kërkesat e publikut dhe jo vetëm:

Çfarë kërkohet, është bashkëpunimi, bashkërendimi i kërkesave të ligjit me njëra tjetrin, përmbushja në kohë e përmbajtje e detyrime ligjore, pasi mekanizmi monitorues është i interesuar jo vetëm për të ndihmuar, por edhe për të kontrolluar dhe zbatuar me përpikmëri çdo parashikim ligjor deri në sanksionim të shkeljeve.

Ligji për të Drejtën e Informimit krijon:

- koordinatorin në çdo autoritet publik, së bashku me kompetencat dhe detyrimet;
- programet e transparencës;
- informimin: pa qenë i detyruar për të sqaruar motivet, apo edhe kufizimet;
- procedura të qarta për ankesat e deri tek sanksionet administrative.

Megjithëse pak kohë, prej hyrjes në fuqi të ligjit të ri për të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit është angazhuar për t'i paraprirë zbatimit të disa kompetencave të cilat lidhen ngushtësisht me afate kohore.

Kemi arritur të hartojmë projektet e para të dokumenteve më të rëndësishme të cilat sot gjenden në këtë tryeze. Do të prezantohen, besoj do të diskutohet e do të ketë sugjerime, do të presim kontributet tuaja në një afat kohor të caktuar, për të arritur më pas në finalizimin e tyre, me qëllim që të arrijmë përdorimin e standardeve të unifikuara së bashku, në përmbushje të dispozitave ligjore.

Do të përmend edhe një kontribut ndoshta modest, por të veçantë, angazhimin e Klinikës së Ligjit, pranë Fakultetit të Drejtësisë, studentët dhe pedagogët, në diskutimet dhe përgatitjen e projekt/akteve.

Besoj se temat dhe diskutimet e kësaj konference do të japin kontribut të rëndësishëm në përmbushjen e qëllimit, objektivave në respektim të të drejtave të njeriut, dhe në mënyrë të veçantë në garantimin e privatësisë dhe të drejtën e informimit, në përputhje me standardet dhe rrugën europiane që kemi zgjedhur.